



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 111, Datë 10.06.2024

**MBI
LICENCIMIN E SHOQËRISË “5GX ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 867/12 prot., datë 05.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes “Mbi licencimin e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 867 prot., datë 03.04.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 64, datë 12.04.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën me nr. 867/3 prot., datë 22.04.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht.
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues të depozituar nga shoqëria, bordi i ERE-s me vendimin nr. 92, datë 13.05.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e

tregtimit të energjisë elektrike, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë apo dhe planifikimin e një seance dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin që ka mbetur ende për t'u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE.

- Me shkresën nr. 867/7 prot., datë 20.05.2023 dhe e-mailin njoftues protokolluar më pas në ERE me nr. 867/8 prot., datë 28.05.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar zhvillimin e një seance dëgjimore, për plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të plotësuar pjesërisht prej saj.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 867/9 prot., datë 30.05.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “5GX ENERGY” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI